



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

KORRIK 2026

BULETINI MUJOR

MINISTRIA E MJEDISIT



Investim modern për menaxhimin e mbetjeve në Bashkinë Vlorë.

Me një investim prej 12.5 milionë eurosh, Landfilli Sanitar i Sherishtës është impianti më modern i depozitimit dhe menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri, pjesë e Programit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve për Rajonin Vlorë Veri, i financuar nga Banka Gjermane për Zhvillim (KfW) dhe i ndërtuar sipas standardeve bashkëkohore europiane.



Nis puna për rehabilitimin e fushës së vjetër të mbetjeve Vlorë.

Në bashkëpunim mes Ministrisë së Mjedisit, Bashkisë Vlorë dhe me mbështetjen e KfW, do të rehabilitojmë ish-hotspotin mjedisor, do të kapsulojmë landfillin e vjetër sipas standardeve mjedisore dhe do të rikuperojmë zonën e vendgrumbullimit të inerteve në ish-Fushën e Aviacionit. Janë 44 hektarë sipërfaqje që i rikthehen komunitetit.



Parku Natyror i Liqenit të Ulzës po hyn në një fazë të re zhvillimi.


Po zbatojmë një projekt rehabilitimi përgjatë vijës liqenore, i konceptuar për të rritur potencialin turistik dhe ekonomik të zonës, duke ruajtur në çdo hap vlerat natyrore të parkut. Projekti përfshin rehabilitimin e vijës liqenore poshtë qytezës së Ulzës, ndërtimin e kullave të vrojtimit, një zip-line, hapësira për plazh në liqen dhe infrastrukturë të re rekreative për vizitorët.



PROGRESI NË 10 VITET E FUNDIT

SHQIPËRIA ME PROGRESIN MË TË MADH MJEDISOR NË RAJON

NDRYSHIMI I REZULTATIT EPI (2016–2026):



Shqipëria ka regjistruar përmirësimin më të madh në Ballkanin Perëndimor gjatë dekadës së fundit.

Burimi: Environmental Performance Index (EPI) 2026 –
Yale Center for Environmental Law & Policy.

Shqipëria kryeson Ballkanin Perëndimor në Indeksin e Performancës Mjedisore 2026.

Shqipëria është renditur në vendin e 46-të nga 177 shtete në botë në Environmental Performance Index (EPI) 2026 me 49.22 pikë, duke u pozicionuar e para ndër vendet e Ballkanit Perëndimor. Gjatë dhjetë viteve të fundit, vendi ynë ka shënuar progresin më të madh në rajon, me një përmirësim prej 10.96 pikësh në indeks.

Ministri Jaupaj zhvilloi një takim pune me Kryetarin e Bashkisë Tropojë, Rexhë Byberi.

Gjatë takimit u diskutuan projektet prioritare që do të transformojnë menaxhimin e mbetjeve në këtë bashki. Në fokus ishte ndërtimi i infrastrukturës së re të menaxhimit të mbetjeve, që përfshin landfillin vendor, qendrën e kompostimit dhe impiantin për rikuperimin e materialeve të riciklueshme.



Ministri Jaupaj merr pjesë në ceremoninë përmbyllëse të Kampit Veror të Tropojës.

Rreth 250 fëmijë zhvilluan një javë plot mësim, kreativitet dhe ndërgjegjësim për mbrojtjen e mjedisit. Në zemër të Alpeve Shqiptare, fëmijët mësuuan se kujdesi për natyrën fillon me veprime të vogla: duke mbajtur pastër mjedisin, duke ricikluar, duke respektuar jetën e egër dhe duke i dhënë një jetë të re materialeve përmes ekonomisë qarkulluese.

➤ Miratohet udhëzimi që përcakton kufijtë e rinj të zhurmës gjatë sezonit turistik.

Vendoset ekuilibër mes zhvillimit të aktivitetit ekonomik, mbrojtjes së shëndetit publik dhe garantimit të qetësisë në zonat turistike. Rregullat do të zbatohen për bare, restorante, klube nate, diskoteka dhe çdo aktivitet që përdor muzikë të amplifikuar ose pajisje elektroakustike.

KUFIJTË E RINJ TË ZHURMËS


ORARI I LEJUAR

11:00 – 20:00: **65** dB(A)

20:00 – 24:00: **45** dB(A)

MATJA

- Niveli i zhurmës matet në intervale **15-minutëshe** me pajisje të certifikuara.
- Kufijtë zbatohen gjatë **sezonit turistik** për aktivitetet që përdorin **muzikë të amplifikuar**.



Miratoheh ndryshimet në ligjin për menaxhimin e kimikateve.

Këto ndryshime heqin barrierat të panevojshme administrative dhe thjeshtojnë procedurat për operatorët ekonomikë. Njëkohësisht, krijojmë mekanizma më të shpejtë për përditësimin e listave të substancave me rrezikshmëri të lartë, duke e afruar më tej legjislacionin shqiptar me standardet e Bashkimit Evropian.

➤ Komiteti i Trashëgimisë Botërore i UNESCO-s pranoi amendamentet e propozuara nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut.

Vlerësim për progresin e arritur dhe angazhimin për mbrojtjen e vlerave të jashtëzakonshme natyrore dhe kulturore të rajonit të Liqenit të Ohrit. Ky vendim është rezultat i punës së përbashkët institucionale, teknike dhe diplomatike, si edhe një nxitje për të vijuar me vendosmëri zbatimin e masave që garantojnë mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të këtij rajoni.



➤ Takimi i parë për rishikimin e strategjisë dhe planeve kombëtare të mbetjeve.

Rishikimi i Strategjisë dhe Planit Kombëtar Sektorial do të harmonizojë objektivat e Direktivës Kuadër të BE-së për mbetjet me prioritetet kombëtare, procesin e integritetit evropian dhe planin e investimeve për dekadën e ardhshme. Dokumenti do të shërbejë si udhërrëfyes për reformën e sektorit deri në vitin 2035.



➤ Nis puna për reformimin e shërbimit hidrometeorologjik në Shqipëri

Ky proces synon modernizimin e një sektori me ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë e qytetarëve, zhvillimin ekonomik dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Me pjesëmarrjen e institucioneve shtetërore dhe partnerëve ndërkombëtarë, nisi puna për hartimin e kuadrit të ri ligjor dhe institucional të shërbimit hidrometeorologjik në Shqipëri.



➤ Takim pune i Ministrit Jaupaj me punonjësit e ADZM Kukës

Stafi i ADZM Kukës është çdo ditë në vijën e parë të menaxhimit të Parkut Kombëtar të Alpeve Shqiptare. Në këtë takim u bashkuan edhe ekspertët e UNEP, në kuadër të projektit GEF/UNEP, me të cilët u diskutuan hapat e nevojshëm për forcimin e qëndrueshmërisë mjedisore dhe financiare të parkut.





Ministri Jaupaj zhvilloi një takim me stafin e ADZM Vlorë

Në bashkëbisedim me punonjësit e ADZM Vlorë për sfidat, përgjegjësitë dhe përditshmërinë e një detyre që shpesh zhvillohet larg vëmendjes, por që është thelbësore për mbrojtjen e pasurive tona natyrore. Në fokus ishte kujdesi për Parkun Kombëtar Detar Karaburun-Sazan, parku i parë dhe i vetëm detar në Shqipëri.

Ministri Jaupaj, takim me delegacionin e Parlamentit European.

Ministri Jaupaj zhvilloi një takim me delegacionin e eurodeputetëve të Parlamentit European, ku u diskutua progresi i Shqipërisë në Kapitullin 27 "Mjedisit dhe Ndryshimet Klimatike", si dhe arritjet në mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetit. Gjatë takimit u trajtua edhe projekti i mundshëm në Zvërnec, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe standardet e Bashkimit European.

